

V E N D I M
Nr.457 datë 21.8.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.311, DATË
11.7.1994 “PËR PËRFITIMIN E PAAFTËSISË”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.311, datë 11.7.1994 “Për përfitimin e paaftësisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

“Gjithë personat e lindur të paaftë ose që janë bërë të tillë para moshës 21 vjeç dhe deri në moshën 24 vjeç kur vazhdojnë studimet e larta, të vërtetuar nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësive për punë (KMCAP), marrin përfitim paaftësie”.

2. Pika 3 ndryshohet si vijon:

“Masa e përfitimit të paaftësisë është 70% e vlerës së pagës minimale dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo e fundit”.

3. Pas pikës 10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

“Të gjithë personat që përfitojnë nga pika 1 e këtij vendimi, kur ndjekin arsimin e mesëm marrin përfitim shkolle në masën dy herë të vlerës së përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi dhe kur ndjekin arsimin e lartë si dhe studimet pasuniversitare, marrin përfitim shkolle në masën 3 herë të vlerës së përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi. Përfitimi i shkollës jepet vetëm për periudhën e vitit shkollor.

Përfituesi ka të drejtën e përfitimit të shkollës edhe kur studimet e tij zgjasin një vit më shumë se sa është kohëzgjatja e përcaktuar e ciklit të shkollës që ai vazhdon”.

4. Shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

“Personat që përfitojnë sipas pikës 1 të këtij vendimi, në të gjitha rastet kur në zonën ku ata banojnë mungojnë shërbimet ditore apo arsimi special dhe Komisioni Mjekësor i caktimit të aftësive për punë përcaktonë se ky person ka nevojë për asistencë të pandërprerë, atëherë një pjesëtar i familjes i zgjedhur nga vetë familja, merr përfitim kujdestarie nëse ai nuk ka të ardhura personale.

Masa e përfitimit të kujdestarisë është 60% e vlerës së pagës minimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave”.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.164, datë 19.4.1994 “Për trajtimin ekonomik të të verbërve”, shfuqizohet.

6. Efekti financiar si rezultat i dhënies së përfitimit shkollor për vitin 1995 është 220 mijë që do të përballohet nga fondi i përfitimit të paaftësisë në buxhetin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe zbatohet si më poshtë:

- Për pikën 2 nga data 1 janar 1996.
- Për pikën 3 nga data e fillimit të vitit shkollor 1995-1996 për përfitimin shkollor.
- Për pikën 4 nga data 1 janar 1996 për përfitimin e kujdestarisë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi